



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.692/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “MB Kurti” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-19332-07-03-2017, me objekt: “*Blerje dru zjarri (Drejtoria Ekonomike e Arsimit)*”, me fond limit 11 159 802 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 11.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Delia Impex” shpk nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Ankimues:

“MB Kurti” shpk
Lagjia “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iljaz Ahmeti”, magazinë 1
katëshe, pranë fabrikës së Qumështit Lushnjë.

Operatori ekonomik “Delia Impex ” shpk
Kutia Postare 166 Shkodër

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shkodër
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit*”

Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar ato, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-19332-07-03-2017, me objekt: “Blerje dru zjarri (Drejtoria Ekonomike e Arsimit”, me fond limit 11 159 802 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 11.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 11.08.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.09.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Ermira Jahiqi (Lulaj)	nuk ka paraqitur ofertë	
- M. B. KURTI	9,073,750 lekë	skualifikuar
- Gjergji Bucca	10.266.300 lekë	skualifikuar
- DELIA IMPEX	11.140.491 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 11.09.2017 operatori ekonomik “MB Kurti” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

a. Kontrata e furnizimit e lidhur me datë 27.07.2017 nuk është për efekt të këtij prokurimi .Kjo kontratë nuk e ka të specifikuar afatin dhe nuk jep garanci për përmbushje të kënaqshme të detyrimit me Bashkinë Shkodër.

b. Për operatorët mungon ‘Leja e shfrytëzimit të pyllit’

c. Sasia e druve e ofuar nga ana Juaj , nuk justifikohet me anë të faturave përkatëse dhe nuk përmbush sasinë e druve të kërkuar nga ana e Bashkisë Shkodër sipas DST prej 1037 m3.

d. Bazuar ne QKR Historik paraqitur nga ana juaj ju ushtroni aktivitet ne qytetin e Lushnjes si dhe ne fshatin Libonik ne Korce.Ne vertetimin leshuar nga OSHEE nr.1913 prot date 03.08.2017 ju deklaroni qe keni kontrate me OSHEE vetem per aktivitetin qe ushtroni ne Qytetin e Lushnjes duke mos pasqyruar aktivitetin qe ushtroni ne qytetin e Korces.

e. Nuk plotesoni piken 2,kapaciteti teknik 2.3 te DST,pasi ju nuk dispononi mjete te pershtatshme per transportin e druve ne te gjitha NJA te Bashkise Shkoder pasi automjeti me targe AA841KJ ne baze te certificates se transportit eshte mjet qe mund te perdoret vetem per llogari te vet dhe nuk mund te perdoret nga te trete,automjeti me targe LU 1928C eshte furgon me dere anesore i papershtatshem per transportin e druve,automjeti me targe AA455RN eshte furgon i mbyllur i papershtatshem per transportin e druve,automjeti me targe LU 7711B eshte furgon i papershtatshem per transportin e druve

f. Nuk keni paraqitur dokumentacionin e nevojshem ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te bindet qe sasia e mallit te kerkuar eshte e depozituar pasi: g. P.Zojza person fizik ndaj te cilit keni blere drute nuk e justifikon kete sasine e shitur me dokumentacionin e paraqitur pasi faturat doganore te blerjes se druve nga ky subjekt jane te vitit 2016,faturat e blerjes se druve nga subjekti Gj.Doda jane te vitit 2015,fatura e blerjes se druve nga M.Delia jane te vitit 2012 ndersa faturat e blerjes se druve nga Gj.Rrasa nuk justifikojne sasine e shitur.

h. Autoriteti Kontraktor nuk bindet nga dokumentacioni i paraqitur se shitesi i druve P.Zojza person fizik disponon sasine e kerkuar te druve ashtu sic eshte shprehur ne kontraten e lidhur me subjektin ofertues M.B Kurti date 27.07.2017 i. Keni paraqitur fatura blerje te druve nga subjekti P.Zojza por nuk keni paraqitur asnje dokument shoqerues si fature

II.5. Në datën 12.09.2017 operatori ekonomik “MB Kurti” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

[...]

Shoqëria jonë analizoi me kujdes arsyetimin e AK-së dhe konkludojmë se skualifikimi është i padrejtë dhe i pabazuar.

Në lidhje me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se:

Kontrata e furnizimit e lidhur më datë 27.07.2017 është tërësisht e rregullt dhe si e tillë ajo shërben për të vendosur një mardhënie midis dy shoqërive. Në të përcaktohet se furnizimi do të kryhet për periudhën që shoqëria “MB Kurti” shpk do të ketë nevojë. Kjo kontratë jep garanci maksimale pasi për më tepër ajo është e konkretizuar dhe me shitje të një sasive prej 1101 m³ dru zjarri. Qëllimi në vetvete i kontratës së furnizimit është që ti japë garanci AK-së që oe-të disponojnë gjëndje sasinë e kërkuar, kanë mundësi reale për të siguruar atë në kohë. Ndërkohë shoqëria “MB Kurti” shpk të gjithë sasinë e kërkuar e disponon gjëndje duke e vërtetuar edhe me fatura blerje.

Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit sqarojmë se:

Shoqëria jonë ka paraqitur “Leje të shrytëzimit të pyllit”pasi e ka siguruar sasinë e kërkuar në forma të tjera konkretisht duke blerë nga subjekte që importojnë produktin dru zjarri.

Në lidhje me arsyen e tretë të skualifikimit sqarojmë se:

Sasinë e druve të kërkuara e kemi vërtetuar duke paraqitur fatura të rregullta blerjeje. Faturat e paraqitura e përmbushin dhe e tejkalojnë sasinë e kërkuar prej 1037 m³ pasi shumatorja e faturave është 1103m³.

Në lidhje me arsyen e katërt të skualifikimit sqarojmë se:

Kemi paraqitur vërtetimin e OSHEE të datës 03.08.2017 sipas formatit standart që lëshohet për oe-të pjesmarrës në procedura prokurimi publik. Vërtetimi është i vlefshëm pasi përfshin edhe faturën koherente të muajit qeshor 2017 që korespondon me datën e hapjes së tenderit. Për vendushtrimin e kativitetit në Korçë shoqëria jonë nuk disponon matës apo kontratë më vete. Ky fakt është vërtetuar paraprakisht edhe nga OSHEE kërkon edhe ekstraktin e QKB-së për të verifikuar adresat e ushtrimit të aktivitetit dhe kontratat e mundshme që mund të ketë oe.

Në lidhje me arsyen e pestë të skualifikimit sqarojmë se:

Nga dy makina transporti të kërkuara shoqëria jonë ka paraqitur 4 të tilla. Ato janë shumë të përshtatshme për transportin e druve pasi aktualisht përdoren për këtë qëllim. AK-ja nuk mund të përcaktojë apriori se çfarë është e përshtatshme ose jo. Për këtë ak-ja duhet të specifikojë në dst tonazhin llojin e mjeteve të kërkuara dhe përsa kohë nuk është kërkuar një tonazh i caktuar, automjetet e paraqitura prej nesh janë më së të përshtatshme.

Në lidhje me arsyen e gjashtë të skualifikimit sqarojmë se:

Kemi paraqitur dokumentacionin e plotë për të vërtetuar që sasia e druve është e depozituar. Faturat e blerjes së druve të zjarrit i kemi të shoqëruara edhe me dokumentat e orgjinës së tyre, konkretisht fatura doganore të shitësit P.Zojza dhe fatura të ndryshme blerjesh brenda vendit të subjektit P.Z. Pavarsisht se disa nga faturat e subjektit P.Z. janë të viteve të kaluara ato janë plotësisht të rregullta pasi artikulli dru zjarri mund të magazinohet dhe ruhet lehtë fare.

Shtojmë nga ana tjetër se shoqëria jonë ka blerë një sasi të caktuar malli dhe nuk është detyra jonë të gjyrmojmë orgjinëen e tyre.

Në lidhje me arsyen e shtatë të skualifikimit sqarojmë se:

Shitësi i druve në mënyrë absolute e dispononte sasinë e druve. Kjo e vërtetuar edhe nëpërmjet dokumentave të paraqitura si fatura doganore ose fatura blerjeje brenda vendit. Është absurde të mendohet se personi fizik P.Z. i ka shitur shoqërisë tonë dicka që nuk disponon dhe që për këtë shitje shoqërisë “MB Kurti” shpki lind detyrimi të likujdojë shitësin e mallit.

Në lidhje me arsyen e tetë të skualifikimit sqarojmë se:

Duke u mbështetur në kërkesat e dst-ve kemi paraqitur deklaratë për vendndodhjen e saktë të mallit në qytetin e Shkodrës. Gjithashtu kemi paraqitur edhe pamje nga fusha e druve ku dallohet qartë se

sasia është depozituar. Për këtë më tepër ak-ja sic e përcaktonte në dst kishte gjithë kohën e nevojshme për të verifikuar që sasia ishte në vendin e deklaruar.

Përsa më sipër argumentuam kërkojmë pezullimin e vazhdimin të procedurës dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “MB Kurt” shpk pasi ka plotëuar të gjitha kërkesat e dst-ve dhe që jep garanci maksimale për realizimin e kontratës.

II.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 13638/1prot., datë 26.09.2017 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit të ankesës vlerëson se ankesa nuk pranohet.

II.7. Në datën 25.09.2017 operatori ekonomik ankimues “MB Kurti” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 11.09.2017 operatori ekonomik “Delia Impex” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsytet si më poshtë vijon:

a. Kontrata e furnizimit e lidhur me date 24.07.2017 , me afat 1 vjekar nuk është nënshkruar nga palët për efekt të këtij prokurimi .Kjo kontratë nuk jep garanci për përmbushje të kënaqshme të detyrimit me Bashkinë Shkodër.

b. Për operatorët mungon ‘Leja e shfrytëzimit të pylli’

c. Për operatorët mungojnë faturat tatimore ose doganore.

d. Mungon nje vertetim per taksat e mjetit te transportit te marre me qera.

II.9. Në datën 18.09.2017 operatori ekonomik “Delia Impex” shpk ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

[...]

Lidhur me skualifikimin argumentojmë:

1. Kontrata e furnizimit e lidhur me date 24.07.2017 , me afat 1 vjekar nuk është nënshkruar nga palët për efekt të këtij prokurimi .Kjo kontratë nuk jep garanci për përmbushje të kënaqshme të detyrimit me Bashkinë Shkodër.

Lidhur me këtë pikë skualifikimi mendoj se është i padrejtë pasi une si operator ekonomik më datë 24.07.2017 kam lidhur kontratë furnizimi me furnizues M. SH. për furnizimin e shoqërisë “Delia Imex” shpk me sasi drurësh prerje 1500m³ kjo sasi drurësh e depozituar pranë furnizuesit me orgjinë madhi dru zjarri sips kontratës së ankandit public që personi furnizues ka lidhur me Bashkinë shkodër me nr. Kontrate 12486/34 datë 20.01.2017 me afat realizimi deri më datë 30.09.2017 nënshkruar nga kryetarja e Bashkisë Shkodër si dhe nga kontraktori , ku bashkëngjit kësaj kontrate gjenden kushtet e vecanta për realizimin e kontratës, pra orgina e mallit është drejtëpërdrejt nga Bashkia Shkodër, së dyti kontrata e furnizimit mendoj se nuk është kusht i domosdoshëm që të shënohet për cfarë efekti bëhet furnizimi. Së treti nqse Bashkia Shkodër mendon se kjo kontratë nuk jep garanci për përmbushjen e kënaqshme të detyrimit me Bahkinë Shkodër nuk ka kryer detyrën e vet ligjore për menaxhimin e kësaj kontrate sipas përcaktimeve në kushtet e vecanta të kontratës.Së katërti mendimi i kvo-së për mos krijim besimi pë roe “Delia Impex” shpk për të furnizuar shkollat e Bashkisë Shkodër me dru zjarri është disi absurd pasi kjo firmë ka furnizuar këto shkolla të Bashkisë Shkodër rreth 10 vite pothuajse pa ndërprerje dhe Bashkia Shkodër në asnjë rast nuk ka pasur as më të voglën vërejtje apo kontesim.

2. *“Për operatorët mungon ‘Leja e shfrytëzimit të pylli’ Për operatorët mungojnë faturat tatimore ose doganore.*

Lidhur me këtë pikë skualifikimi mendoj se është e padrejtë pasi si kontrata ashtu dhe leja e shfrytëzimit janë pjesë e Bashkisë Shkodër (sic është prokurimi blerje dru zjarri)dhe fare lehtë e verifikueshme nga ana juaj. Prandaj ky veprim të konceptohet conform nenit 53 pika 4 e LPP-së referojmë nenin[...]

3. *Mungon nje vertetim per taksat e mjetit te transportit te marre me qira.*

Për mjetin që ju i referoheni ju bëj me dije se ju dispononi dokumentacionin ligjor që duhet të ketë një automjet që del në rrugë, si leje qarkullimi, certifikatë kontrolli teknik siguracionin e mjetit këto të mjaftueshme për të vërtetuar rregullsinë e një mjete transporti, prandaj mendoj se është i padrejtë ky skualifikim në të kundërt nëse kjo mendon ndryshe të preceptohet përsëri conform nenin 53 pika 4 e LPP-së referojmë nenin[...].

Njëkohësisht i kërkoj Bashkisë Shkodër që të verifikojë oe-në “MB Kurti” shpk mbi rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Shkodër, njëkohësisht mendoj se sasia e drurëve e ofruar për Bashkinë Shkodër nuk e disponon kjo kompani pasi e ka shitur në po tnjëtin institucion të Bashkisë Shkodër pra tek Drejtoria e Cerdheve institucion në varësi pot ë Bashkisë Shkodër.

Përsa më sipër kërkoj:

Ndalimin e veprimeve të mëtejshme nga Bashkia Shkodër. Rivlerësim të oe-së “Delia Impex” shpk duke e kualifikuar dhe shpallur fitues të kësaj procedure prokurimi.

II.10. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 13827 prot datë 27.09.2017 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Delia Impex” shpk në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...]

1. *Ju jeni skualifikuar nga KVO me këtë pretendim:*

Kontrata e furnizimit e lidhur me date 24.07.2017 , me afat 1 vjecar nuk është nënshkruar nga palët për efekt të këtij prokurimi .Kjo kontratë nuk jep garanci për përmbushje të kënaqshme të detyrimit me Bashkinë Shkodër.

Në formualrin e ankesës drejtuar AK-së ju kundërshtoni këtë vendim me pretendimin se kjo kontratë është mëse e rregullt pasi është lidhur me një shoqëri e cila ka lidhur kontratë shfrytëzimi me Bashkinë Shkodër dhe është mëse e besueshme.Bazuar në dst e publikuara nga AK-ja Kapaciteti ekonomik dhe financiar2.3. pika 4 [...]

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në spe nga ana juaj në përmbushje të këtij kriteri ju keni paraqitur kontratë furnizimi nr. 1607rep datë 24.07.2017 me subjektin M.SH. ku përcaktohet sasia prej 1500m3, sasi e cila i plotëson nevojat e AK-së për dru zjarri, afati 1 vjecar që mbulon afatin e furnizimit të kërkuar ka bazën ligjore sipas përcaktimeve në K.C është një dokumet që ka dy vula ku njëra prej tyre është e thatë ka nënshkrimin e palëve si dhe të noterit.Ky dokumnt është në përputhje me nenet 773 e vijues të K.C. dhe ligjin nr. 7829 datë 01.09.1994 “Për noterinë” i ndryshuarneni 17 si dhe kërkesat e përcaktura në dst.

Përsa më sipër ankesa juaj për këtë pikë është e drejtë dhe merret parasysh.

2. *Ju jeni skualifikuar nga KVO me këtë pretendim:*

Për operatorët mungon 'Leja e shfrytëzimit të pylli'

Në formularin e ankesës drejtuar AK-së ju kundërshtoni këtë vendim me pretendimin se leja e shfrytëzimit të pyllit ashtu dhe kontrat janë pjesë e Bashkisë Shkodër dhe fare lehtë mund të verifikoheshin. Bazuar në dst e parashkuara nga AK-ja Kapaciteti ekonomik dhe financiar 2.3. pika 4[...]

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në system nga ana juaj në përmbushje të këtij kriteri ju keni paraqitur lejen e shfrytëzimit të pyllit të furnizuesit për të shoqëruar kontratën e furnizimit.

Referuar nenit 53 pika 3 dhe 4 të LPP-së[...]

Mungesa e lejes së shfrytëzimit të pyllit të furnizuesit mundtë konsiderohet një devijim i vogël që nuk çënon thelbin e ofertës përse kohë që procedura e ankandit për shfrytëzimin e lëndës drusore është organizuar nga vet Bashkia Shkodër e cila ka lidhur kontratën e shfrytëzimit dhe ka lëshuar lekjen përkatëse me këtë subject.

Përse më sipër ankesa juaj në lidhje me këtë pikë është e drejtë dhe merret parasys.

3. Ju jeni skualifikuar nga KVO me këtë pretendim:

Mungon nje vertetim per taksat e mjetit te transportit te marre me qira.

Në formularin e ankesës drejtuar AK-së ju kundërshtoni këtë vendim me pretendimin se dokumentat kryesore që një automjet del në rrugë janë , si leje qarkullimi, certifikatë kontrolli teknik siguracionin e mjetit, leje transporti dhe mosparaqitja e taksës është thjesht një devijim.

Bazuar në DST-të e publikuara nga AK-j Kapaciteti ekonomik dhe financiar 2.3.2 kërkohet:

Dy makina transporti te shoqeruara me (leje qarkullimi), akt kolaudimi, policën e sigurimit të mjetit,taksat si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë te pershtatshme per transportin e druve..

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në system nga ana juaj në përmbushje të këtij kriteri për automjetin me targë SH 5494D ju nuk keni paraqitur taksat e paguara. Referojmë nenin 53/3 të LPP-së pika 4 [...]

Në dokumentat standarte të tenderit "Udhëzime për operatorët ekonomikë përcaktoht:

"Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen sit ë papranueshme".

Përse më sipër skualifikimi i bërë nga KVO-ja është i drejtë dhe i mbështetur në kriteret e vendosura në dst dhe pretendimi juaj nuk qëndron.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës bazuar në nenin 53 pika 3 dhe 4 të LPP-së, vlerësojmë se ankesa juaj nuk është pjesërisht e drejtë dhe refuzohet.

II.11. Në datën 02.10.2017 operatori ekonomik ankimues "Delia Impex" shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentat si më poshtë vijon:

[...]

Më datën 18.09.2017 me nr. Prot 13827 kemi depozituar ankesën tonë pranë Bashkisë Shkodër. Ku kemi dhënë argumentimet tona për skualifikimin e padrejtë, Më datë 27.09.2017 me nr. Prot 13827 kemi marrë përgjigje nga Bashkia Shkodër lidhur me ankesën tonë , ku ankesa jonë pranohet


pjesërisht ku jepen dhe detaje të pranimit të ankesës. Dhe përsëri mbetemi të skualifikuar për pretendimin e mëposhtëm të AK-së.

Lidhur me këtë pikë që në mbetemi të skualifikuar përsëri sqarojmë:

Mungon një vertetim për taksat e mjetit të transportit të marre me qira.

Për mjetin që ju i referoheni ju bëj me dije se ju dispononi dokumentacionin ligjor që duhet të ketë një automjet që del në rrugë, si leje qarkullimi certifikatë kontrolli teknik, siguracionin e mjetit, këto të mjaftueshme për të vërtetuar rregullsinë e një mjete transporti, prandaj mendoj se është i padrejtë ky skualifikim, në të kundërt nëse KVO-ja mendon ndryshe të preceptohet përsëri komform nenit 53 pika 4 e LPP-së ku thuhet[...] “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen”. Përsa më sipër kërkojmë KPP-së ndalimin veprimeve të mëtejshme nga Bashkia Shkodër rivlerësim të oe-së “Delia Impex” shpk duke e kualifikuar dhe shpallur fitues të kësaj procedure.

II.12. Njëpër një shkresës nr. 14597 prot., datë 02.10.2017 protokolluar me tonën me numër 1512/2 prot., datë 04.10.2017, si dhe shkresës nr. 14975 prot., datë 09.10.2017, protokolluar me tonën 1536/2 prot., datë 13.10.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.



III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “MB Kurti” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Nuk plotësoni piken 2, kapaciteti teknik 2.3 të DST, pasi ju nuk dispononi mjete të pershtatshme për transportin e druve në të gjitha NJ.A të Bashkisë Shkodër pasi automjeti me targë AA841KJ në bazë të certifikatës së transportit është mjet që mund të perdoret vetëm për llogari të vet dhe nuk mund të perdoret nga të tjerë, automjeti me targë LU 1928C është furgon me dërrësorë i papershtatshëm për transportin e druve, automjeti me targë AA455RN është furgon i mbyllur i papershtatshëm për transportin e druve, automjeti me targë LU 7711B është furgon i papershtatshëm për transportin e druve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

1. Dy makina transporti të shoqeruara me (leje qarkullimi), akt kolaudimi, policën e sigurimit të mjetit, taksat si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë të pershtatshme për transportin e druve..

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “MB Kurti” shpk në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- i. Mjeti me targë AA455RN.
- ii. Mjeti me targë LU 1928C.
- iii. Kamion me targë LU7711B.
- iv. Kontratën e qiraje Nr. 620 Rep dhe Nr.370 Kol datë 27.02.2017 lidhur mes shoqërisë “M B Kurti” sh.p.k. dhe personit fizik A.H me objekt “dhënien me qira kundërshtëpërbliim shoqërisë “M B Kurti” sh.p.k. mjetin e mëposhtëm: Kamion me targë AA814KJ

III.1.2.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

Për mjetin me targë AA455RN operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik, Certifikatën e pronësisë (“MB Kurti” shpk).

Për mjetin me targë LU 1928C operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik, Certifikatën e pronësisë (“MB Kurti” shpk).

Për Kamion me targë LU7711B operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik, Certifikatën Nr.423 datë 06.12.2017 “Për Transport Brenda Vendit për Llogari të Vet”, lëshuar nga Bashkia Fushë Lushnjë.

Për Kamion me targë AA814KJ operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik, Certifikatën Nr.51 datë 16.01.2017 “Për Transport Brenda Vendit për Llogari të Vet”, lëshuar nga Bashkia Fushë Lushnjë.(Kontratën e qiraje Nr. 620 Rep dhe Nr.370 Kol datë 27.02.2017 lidhur mes shoqërisë “M B Kurti” sh.p.k. dhe personit fizik A.H)

III.1.3. Në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]”

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;

- e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
- f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet. 8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]"

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", parashikohet se : " [...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]"

Në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", parashikohet se : "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse."

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se *lex specialis*, Ligji "Për Transportet Rrugore" bën qartësisht ndarjen midis licencës lëshuar Transport për vete përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi. Si edhe licencës lëshuar për Transport për të tretë dhe me qira përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. Në rastin konkret përmes dokumentacionit dorëzuar vërtetohet se licenca të cilën disponon personi fizik A.H. është specifike dhe e lëshuar vetëm për Transport për vete përmes të cilës është i licencuar vetëm subjekti personi fizik A.H. për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ane shoqërisë "MB Kurti" sh.p.k. të mallrave me kamionët e personit fizik. A.H. do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit "Për Transportet Rrugore" është i ndaluar.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në Shtojcën 7 "Kriteret e vecanta të kualifikimit" pika 2 "Kapaciteti teknik" të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi detyrimin e operatorëve ekonomikë ankimes që për makineritë dhe pajisjet duhet të vërtetohen me dokumente që janë në pronësi ose me akt përdorimi të operatorit ekonomik". K.P.P gjykon se Licenca e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjete është në përdorim nga operatorët ekonomikë. Mungesa e Licencës së mësipërme, vërteton vetëm faktin se mjete mund të jetë në pronësi, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor".

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës, pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimuese “MB Kurti” shpk, mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues “MB Kurti” shpk nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Delia Impex” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsytimin se “Mungon nje vertetim per taksat e mjetit te transportit te marre me qira”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2. *Dy makina transporti te shoqeruara me (leje qarkullimi), akt kolaudimi, policën e sigurimit të mjetit, taksat si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë te pershtatshme per transportin e druve..*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Delia Impex” shpk në përmbushje të kritereve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- i. *Kontratën e qiraje datë 08.01.2016 lidhur mes shoqërisë “Delia Impex” sh.p.k. dhe personit fizik Gj.N. me objekt “dhënie me qira shoqërisë “Delia Impex” sh.p.k. mjetin e mëposhtëm: Kamion marka Mercedes Benz; tipi 67914D; Nr. Shasie EDB67402215199073; Targa sh 5494D; Ngjyra e zezë[.] bashkëlidhur leje e qarkullimit nr. SH0530212; Certifikatën e Kontrollit Teknik; Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin); Certifikatën Nr.13 datë 20.11.2014 “Për Transport Brenda Vendit për Llogari të Vet”, lëshuar nga Komuna Pult; fotografi e mjetit.*
- ii. *Kamion me targë AA518EU operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar lejen e qarkullimit, Policën për Sigurimin e Detyrueshëm për Mjetet Motorike për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (Siguracionin), Certifikatën e Kontrollit Teknik, Certifikatën Nr.17 datë 15.10.2014 “Për Transport Brenda Vendit për Llogari të Vet”, lëshuar nga Komuna Pult, Taksa vjetore e mjeteve, fotografi e mjetit.*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..”*

III.3.4. Në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, neni 4 “Niveli i taksave kombëtare, është parashikuar:

“[...] E ardhura nga taksa , për çdo rast, mbliidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtorisë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit [...].”

Ndërsa në Udhëzimin nr.8/1, datë 15.05.2013 “Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 09.04.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”, thuhet:

“[...] Pagesa e taksës bëhet brenda afatit të vlefshmërisë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj por jo më shumë se 25% për çdo vit. [...]”

Bazuar në sa mësipër KPP gjykon se, ankimuesi me dokumentacionin e paraqitur, plotëson kriterin e sipërcituar, pasi përpara se automjeti të kalojë procesin e kontrollit, duhet të jenë paguar taksat vjetore të automjetit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomikë “Delia Impex” shpk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “MB Kurti” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-19332-07-03-2017, me objekt: *“Blerje dru zjarri (Drejtoria Ekonomike e Arsimit”*, me fond limit 11 159 802 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 11.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Delia Impex” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik “Delia Impex” shpk të korrigojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Delia Impex” shpk .
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryer.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Delia Impex” shpk
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1512 Protokoli, Datë 25.09.2017

Nr.1536 Protokoli, Datë 02.10.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

